



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 shkurt 2013
Nr.Ref.:RK375/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI-89/12

Parashtrues i kërkesës

Brahim Delijaj

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Brahim Delijaj me banim në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, dorëzuar parashtruesit të kërkesës me datë 18 qershor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me kërkesën e Parashtruesit për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012 dhe vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 83/2008 të 22 prillit 2009, lidhur me të drejtën e servitutit të përhershëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56, pika 2, të Rregullores së Punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 tetor 2012, Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me vendimin e Kryetarit Nr. GJR. KI 89/12 të datës 31 tetor 2012, Gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi është caktuar Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për caktimin e kolegjit shqyrtues me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).
7. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me regjistrimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi në kërkesën e tij pohon se është pronar i ngastrës kadastrale me nr. 114 në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.08,24 hektar në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit. Sipas dokumenteve të bashkëngjitura në kërkesë, në anën lindore kjo ngastër kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 111 e evidentuar në emër të të ndjerit Sejd Hasan Delijaj, i ati i Isuf, Përparim dhe Hasan Delijaj, të cilët e kanë në shfrytëzim dhe posedim, njëherit edhe kushërinj të parashtruesit të kërkesës. Në skajin verilindor gjendet dera e oborrit e parashtruesit të kërkesës e cila lidhet me rrugën publike dhe kalon nëpër ngastrën kadastrale nr. 111 në gjatësi prej 8 metrave dhe gjerësi prej 4 metrave, po ashtu në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit.
9. Më 18 gusht 2004, parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Komunale të Deçanit ka kërkuar t'i pranohet e drejta e servitutit të përhershëm nëpër ngastrën nr. 111. Parashtruesi i kërkesës, më 5 korrik 2007, në bazë të të dhënave kadastrale ka precizuar parashtruesin e tij me pretendimin se është pronar i ngastrës nr. 114/2 në sipërfaqe prej 0.04.12 hektarë.
10. Gjykata Komunale në Deçan me Aktgjykimin e saj C. Nr. 130/06 të 19 dhjetorit 2007 mbi bazë të nenit 59 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke

vlerësuar se parashtruesi i kërkesës nuk është i izoluar, por ka një komunikim dhe lidhje normale me rrugën publike të fshatit. Gjykata Komunale në Deçan ka vlerësuar më tej se parashtruesi i kërkesës në rastin e ndarjes me vëllanë e tij, nuk e ka ushtruar të drejtën e servitutit të kalimit 35 vite dhe, po ashtu, nuk ka siguruar rrugën e kalimit.

11. Parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 83/08 të 22 prillit 2009 ka aprovuar kërkesëpadinë e Parashtruesit të kërkesës vetëm në pjesën e vërtetimit të ekzistimit të servitutit të kalimit të përhershëm nëpër pjesën perëndimore të ngastrës kadastrale nr. 111.
12. Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 83/08 të 22 prillit 2009 ka vlerësuar se “ *nuk e aprovon si të ligjshëm dhe të rregullt qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë* “. Gjykata e Qarkut më tej ka vlerësuar se [...] “ *në këtë çështje juridike është vërtetuar fakti vendimtar për të vendosur se, është ndryshuar vëllimi dhe përmasat e ushtrimit të drejtës së servitutit nga ana e palës paditëse mirëpo, nga kjo nuk rrjedhë vlerësimi se pala paditëse nuk e ka shfrytëzuar rrugën kontestuese për kalim.*” dhe në fund ka konstatuar se [...] në “*këtë çështje juridike gabimisht është aplikuar e drejta materiale [...]*.”
13. Pala kundërshtarë ka parashtruar revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në Gjykatën Supreme të Kosovës me arsyetimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
14. Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës me 18 qershor 2012, ka pranuar revizionin e parashtruar nga të paditurit si të bazuar, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe vendosur që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të mbetet në fuqi me arsyetimin se Gjykata e Qarkut gabimisht ka zbatuar dispozitat materialo-juridike. Gjykata Supreme, duke ju referuar nenit 49, paragrafit 1, të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore të 30 janarit 1980 më tej ka vlerësuar [...] “*se servituti real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajtshme (prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejë veprimet e caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do t'i kishte drejtë t'i kryente në pasurinë e vet të paluajtshme, çka nënkupton që personat që nuk janë pronar i pasurisë sunduese nuk kanë të drejtë të kërkojnë me padi mbrojtje gjyqësore.*” Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj në fund konstaton se “*poseduesi i parcelës i cili nuk është pronar, nuk ka të drejtë që me padi të kërkojë vërtetimin e ekzistimit të drejtës servitutit real të rrugës ndaj pronarit të pasurisë shërbyese.*”
15. Më 7 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ka paraqitur propozim për ngritjen e kërkesës për ligjshmëri te Prokurori i Shtetit.

16. Prokurori i Shtetit, më datë 30 korrik 2012, pas shqyrtimit të lëndës, ka refuzuar ngritjen e kërkesës për ligjshmëri. Në njoftimin e tij, Prokurori i Shtetit konsideron se [...] “ në këtë çështje juridiko-civile Gjykata Supreme ka marrë aktgjykim duke vepruar sipas revizionit të paditurve dhe kundër një aktgjykimi të tillë Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk është e lejuar.”

Ligji i aplikueshëm, të cilit i referohet Gjykata Supreme

17. Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006) në nenin 182, paragrafin 1 dhe 2, si dhe nenin 224, paragrafi 1, përcaktojnë si në vijim:

“ 182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.”

18. Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore i 30 janarit 1980 (publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 6/80) nenin 49, paragrafin 1 dhe nenin 59 përcakton:

Neni 49, paragrafi 1

“Servitut real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajtshme (prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejë veprime të caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do të kishte drejtë ti kryente në pasurinë e vet të paluajtshme.”

Neni 59

“Në qoftë se pjesëtohet prona sunduese servituti real mbetet në dobi të të gjitha pjesëve të saj.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që servituti real i pronarit të ndonjë pjesë të pronës sunduese të pjesëtuar të pushojë, poqese servituti real nuk shërben për nevojat e kësaj pjese.

Në qoftë se është pjesëtuar prona shërbyese, servituti real mbetet vetëm mbi pjesët për të cilat është ushtruar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, me të cilin refuzohet revizioni i parashtruar, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, më saktësisht nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 121 [Prona] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
20. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 374/2009 i 2 majit 2012 dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 83/2008 i 22 prillit 2009.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës të parashtrrojë kërkesë në Gjykatë.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata vëren se parashtruesi, është person fizik dhe është palë e autorizuar në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 [Kërkesat Individuale] të Kushtetutës.

23. Gjykata, po ashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
Në rastin konkret, Gjykata vëren se janë parashtruar ankesa dhe kërkesa për revizion sipas procedurave të përcaktuara me Ligj, përkatësisht në Gjykatën Komunale në Deçan, në Gjykatën e Qarkut në Pejë, si dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe rrjedhimisht janë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

24. Parashtruesi gjithashtu duhet të dëshmojë se ai i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga dosja e lëndës mund të shihet se vendimi i Gjykatës Supreme, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar me 18 qershor 2012, derisa parashtruesi e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 4 tetor 2012, që nënkupton se kërkesa ishte dorëzuar brenda afatit katër mujor, të paraparë në Ligj dhe Rregullore të punës.
25. Në lidhje me kërkesën, Gjykata merr po ashtu parasysh Rregullin 36 të Rregullores, ku përcaktohet:
- “(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar.”
26. Bazuar në shkresat e kërkesës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në vendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata po ashtu ka vërtetuar se procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituaniës*, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
27. Gjykata dëshiron të rikujtojë se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e fakteve, dhe në këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore (Shih, *mutatis mutandis*, i.a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).
28. Gjykata po ashtu dëshiron të rikujtojë se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I, Shih gjithashtu, *Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin nr. 70/11*, Parashtruesit e kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08 të 7 shkurtit 2011).
29. Fakti se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e vendimit të Gjykatës Supreme, nuk mund t’i shërbejë atij si e drejtë që të ngrisë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 121 [Prona] të Kushtetutës dhe nenit 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të KEDNJ-së (Shih, *mutatis mutandis Aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
30. Si përfundim, sipas fakteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih, *mutatis*

mutandis, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

31. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani